

SINOPSIS ROMANI “SHPELLAT”

R. C. ANAIDER

Romani “Shpellat” flet për një udhëtim imagjinar në një botë të konceptuar në trajtën e shpellave, shpella këto aspak të zakonshme apo konvencionale, ku përpalsen konceptet e dritës dhe errësirës, lirisë dhe izolimit, dashurisë dhe urrejtjes, familjes dhe vetmisë, lumturisë dhe fatkeqësisë.

Ka shpella mbi oqean, siç ka dhe shpella nën oqean. Ka edhe shpella mbi ajër...

Tek shpellat flitet për njeriun, për vehten, për tjetrin, për të tjerët, për gjuhën, për kulturat, për pengesat e fatit si dhe për magjinë e rastësisë, e cila vjen gjithnjë befasishëm, duke i çuar personazhet në dimensione krejt të panjohura, përmes së cilave shpalolet një tjetër bashkësi shpellare, që të çon tek një tjetër, dhe tek një tjetër... Në këtë libër flitet për dashurinë, si një forcë e jashtëzakonshme, e cila udhëheq në thellësi fatin e personazhit kryesor të “Shpellave”, ëndrra më e madhe e së cilës ishte të gjente një “shpellë” që mund ta konsideronte si “shtëpinë e saj”. Dhe sigurisht që bërthama e shtëpisë për të ishte dashuria, liria, paqja, totalisht e kundërta e “izolimit”.

Asnjë personazh nuk ka emër dhe jo çdo personazh ka një nofkë të “Shpellat”. Nuk ekziston asnjë shtet, qytet, apo fshat konkret në bashkësinë e madhe shpellare, por çdokush mundet të gjejë shpellën e vet në botën e “Shpellave”.

Personazhi kryesor i “Shpellave” është “Silueta C”, një vajzë jetime, e cila pasi arratiset nga jetimorja, zhvendoset të jetojë në Bodrumin e “Shpellës së Kalasë”, ku njihet me shpellarë, të cilët, do të shndërrohen rastësisht në familjen e saj të gjetur. Pasi kalon shumë vite të jetës së saj në një shpellë të zhytur 10 mijë metra në ujë, nën oqeanin e mbuluar me peshkaqenj të panumërt, “Silueta C”, largohet, duke vijuar të kërkojë dhe ëndërojë për dritën, lirinë dhe shtëpinë e saj.

Udhëtimi i Siluetës C do të vazhdojë në “Shpellën e borës”, në një skaj kaq të largët të bashkësisë shpellare dhe kaq të ndryshëm nga shpella e saj e lindjes. Aty jo vetëm edukohet, por edhe dashurohet, për herë të parë, me një personazh autentik që mban emrin “Korbi i Zi”, i cili do ta përndjekë “Siluetën C” përgjatë gjithë udhëtimit të saj shpellar, duke e detyruar atë të ndërrojë mendjet dhe maturohet për gjetjen (rigjetjen) e lirisë së saj të humbur.

E shtyrë mbase nga dëshira e krijimit të një shpelle më të mirë, “Silueta C” mbledh gjithë forcat e saj për të krijuar një shpellë 10 mijë metra mbi ujë, ku kërkonte të gjente dritën e munguar ndër vite. Ishte pikërisht “Shpella e tullumbacave”, shpella e ajrit, ku “Silueta C”, përveç të tjerave, gjen forcën të sfidojë vetveten, duke pranuar me vetveten të humbasë, me qëllimin për të korrur fitore të tjera, në të ardhmen e afërt, apo mbase të largët.

Ajo lufon gjatë me vehten, lufton me “Korbin e Zi” dhe krijon “Shpellën e kutive të kartonit”, përmes një plani që i ngjante një “koni të përmbysur”. Dhe sërish humbet, duke fituar... Dhe sërish fiton, duke humbur...

Një ditë rrëzohet, si pasojë e një sulmi të jashtëm (po aq sa edhe të brendshëm) edhe shpella e saj e “Kutive të kartonit” me 50 mijë shpellarët e saj. Silueta C, pas këtij “tërmeti” bie krejt rastësisht në një tjetër shpellë, totalisht të panjohur, që ajo e quan “Shpella e ballove me maska”. Kjo është shpella e paradokseve, e verbërisë, e vuajtjes, e shitblerjes së shpirtit, turpit dhe trupit.

Gjatë një përpjekjeje të turbullt për të luftuar me kompleksin e pakuptimtë të mposhtjes së frikës së çuditshme ndaj merimangave në dhomën e saj në “Shpellën e ballove me maska”, “Silueta C” zbulon “Shpellën e urave”, e cila ishte vetëm një ballkon larg nga grija dhe tavanet e larta ku izoloheshin femrat e vuajtura, siç ishte, me sa duket, edhe ajo vet.

Pikërisht në “Urën e kyçeve të dashurisë” (një ndër mijëra urat e Shpellës së urave) ajo takohet me dashurinë më të madhe të jetës së saj, me “Koleksionistin e çadrave”, i cili do ta bënte atë të ëndërrojë për shtëpinë e saj në “Shpellën e çokollatave”.

Në kërkim të gjetjes së një korridori shpellar për t’u takuar sërish me shpellarin që i rrëmbeu asaj zemrën, dhe pa asnjë rrugëdalje tjetër në ndonjë “shpellë mbi oqean”, “Silueta C” përfundon në “Shpellën e humbur”, pikërisht në shpellën e thëllë nënoqeanike, në epiqendrën e prodhimit të vuajteve, prej të cilës ajo mezi u arratis që kur ishte akoma shumë më e re.

Në përpjekje e sipër për të shkuar nga “Shpella e humbur” drejt “Shpellës së çokollatave”, Silueta C përfundon shumë rastësisht, në “Shpellën e panjohur”, në vendlindjen e “Koleksionistit të çadrave”.

Gjtë kohës së vizitës së saj disa ditore në “Shpellën e panjohur”, fillon një pandemi e madhe mbarëshpellare prej të ashtuaquajturit “Virusi VV3 Delta Plus”, për faj të të cilit (të paktën për nga rrethanat) Silueta C mbetet e bllokuar për një periudhë të gjatë e të panjohur, në një shpellë po kaq të panjohur për të, duke mbajtur gjallë shpresën për t’u takuar sërish, një ditë mbase të afërt, me “Koleksionistin e çadrave”, në shtëpinë e saj të ëndrrave, diku në “Shpellën e çokollatave” apo në ndonjë tjetër shpellë, ku fati dhe rastësia (kaq kapriçioze me të) mund ta çonte...

Në fund të romanit, pikërisht gjatë qëndrimit të Siluetës C në “Shpellën e panjohur” hidhet dritë mbi fatet e personazheve kryesore, duke ndriçuar në këtë mënyrë dimensione të reja dhe të thella, prej të cilave lindin edhe dilema të reja për lexuesin.